

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

MANJA NË KOSOVË, TAKIME ME OSMANIN, KURTIN E HAXHIUN

Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja shoqëruar nga një delegacion me drejtuesit më të lartë të institucioneve të varësise dhe Ministrisë së Drejtësisë, zhvilloi një vizitë dy ditore në Kosovë. Z.Manja zhvilloi takime me krerët më të lartë të Kosovës. Kështu në takimin që pati me Presidenten znj. Vjosa Osmani u diskutua vetëdijimi në drejtësi që pret të bëjë Kosova, sundimin e ligjit, dhunën në familje, çështjen e të zhdukurve nga lufta, ku një pjesë e madhe janë fëmijë. Palët ndanë mendimin e përbashkët se lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, janë jo vetëm përmbushje e detyrave që rrjedhin nga procesi i integritimit euroatlantik, por në rradhë të parë nevojë për qytetarët. Z. Manja zhvilloi një takim edhe me Kryeministrin e Kosovës z.Albin Kurti, ku janë biseduar disa çështje me rëndësi në fushën e drejtësisë, teksa Kosova ka nisur hapat e parë të Reformës në Drejtësi dhe procesin e Vetëdijimit. Z.Kurti është interesuar për rrugëtimin e Shqipërisë përjetat Reformës në Drejtësi dhe vetëdijimit, ndërkohë që z.Manja ka ofruar gjithë përvojën, burimet njerëzore dhe ekspertizën më të mirë në ndihmë të këtyre proceseve në Kosovë. Z.Manja është takuar edhe me homologen e tij znj. Albulena Haxhiu, ku një nga pikat kryesore ishte përfundimi i një marrëveshjeje për njohjen dhe zbatimin e dënimeve alternative, e cila do të mundësojë mbikqyrjen nga organet përgjegjëse të vendeve respektive për personat e liruar me kusht. Po ashtu u ra dakort për jetësimin e tre nismave përmes të cilave garantohet reciprociteti në lejimin e ushtrimit të profesionit të avokatit dhe ndërmjetësuesit në shtetet përkatëse, si dhe njohja e ndërsjellë e provimit të jurisprudencës. [LEXO PËR MË SHUMË](#)



MANJA: SHËRBIMI I PROVËS ËSHTË NË "PROVË"

Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja përgjatë një analize pune në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, ka kërkuar përgjegjësi maksimale nga të gjithë punonjësit në rradhët e këtij institucioni, si një garanci për vënien në jetë të synimeve dhe vizionit për këtë shërbim. Sipas Manjës, pa një angazhim maksimal dhe serioz nuk mund të jetëzohen objektivat. Ai rreshtoi disa prej tyre si rishikimin e strukturës, dixhitalizimin e proceseve, përmirësimin e akteve ligjore dhe mbi të gjitha sistemi i unifikuar i Shërbimit të Provës, inovativ dhe proaktiv. Ministri ka lënë edhe disa afate për zbatimin e detyrave. [LEXO PËR MË SHUMË](#)



DIPLOMOHEN MAGJISTRATËT E RINJ 2019-2022

Gjatë një fjalimi në ceremoninë e diplomimit të magjistratëve të rinj 2019-2022, Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja ka uruar ata në nisjen e një rrugë të vështirë që duhet të kthejë besimin e qytetarëve tek drejtësi, por që gjithçka tashmë është në ndërgjegjen dhe profesionalizmin e tyre, pasi Reforma në Drejtësi, Vetëdijimi dhe Shkolla e Magjistraturës nga e cila sapo dolën, tashmë e kanë kryer volumin më të madh të punës. [LEXO PËR MË SHUMË](#)



SHKURT

MANJA -TUPANCHESKI: BE VIZIONI YNË I PËRBASHKËT



Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja ka pritur një delegacion nga Maqedonia e Veriut të kryesuar nga Ministri i Drejtësisë z. Nikola Tupancheski. Gjatë takimit të tyre ata shkëmbyen përvojat e përbashkëta për integrimin në Bashkimin Evropian si vende që e kanë të përbashkët këtë sfidë, por edhe për Reformën në Drejtësi. Bashkëbiseduesit u dakortësuan se të dy vendet kanë fokusin në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit dhe se përpjekjet e dyanshme mund të fuqizohen duke përfshirë bashkëpunimin gjyqësor rajonal. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

QBZ, PLATFORMË SOFTWARE PËR KËRKIMIN E AKTEVE



Pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare është ngritur një platformë software e cila bën të mundur regjistrimin, ruajtjen dhe kërkimin e akteve të botueshme. Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja duke folur për prioritetet ka përmendur krijimin e Librarisë Ligjore të Akteve nga formimi i shtetit shqiptar. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

N.J, QENDRA TË REJA SIPAS HARTËS GJYQËSORE



Pas miratimit të buxhetit të ri 2023, do të bëhet e mundur hapja e qendrave të reja të Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore sipas hartës së re gjyqësore. Këtë e ka bërë të ditur Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja gjatë një takimi në zyrat e Drejtorisë së Ndhimës Juridike. Ai ka nënvizuar se çdo individ duhet të ketë të garantuar ndihmën juridike në çdo kohë dhe vend. [LEXO PËR MË SHUMË](#)